



Komuna Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06 - 26903 /19

Klinë, 27. 06 - 2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja Debat me Publikun, e mbajtur, më 19.06.2019, në sallën e Kuvendit të Komunës, me fillim në orën 10:00.

Rendi i Ditës

1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022

Në mbledhje ishin prezent:

Prof.dr.Zenun Elezaj-Kryetar

OJQ"KOHA"- Florida Gashi

KFOR, KDI, OSBE,

Si dhe 30 pjesëmarrës tjerë, qytetarë të Komunës sonë.

Debatin me Publikun e hapi z. Fadil Gashi kryesues, fillimisht përshëndeti, kryetarin Zenun Elezaj, organizatat joqeveritare, zyrtar të administratës dhe ju qytetarë të nderuar, dëshira ime do të ishte që pjesëmarrja të ishte akoma më e madhe sidomos kur është në diskutim një dokument aq i rëndësishëm siç është Korniza Afatmesme Buxhetore, ku debatohet dhe sugjerohen orientimet për investime për tri vitet e ardhshme, duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, rregulloren, statutin e Komunës, ligjin për menaxhimin e financave lokale, ne kemi organizuar këtë debat për dëgjim dhe mirëpresim çdo sugjerim në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore, ju të cilët jeni prezent në këtë mbledhje, besoj se çdonjëri e keni para vetes draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, unë fillimisht po i jap fjalën drejtorit Aziz Desku që ta bëjë prezantimin e këtij drafti dhe pastaj do të hapi debat, urdhëroni drejtor!

z.Aziz Desku drejtor i FEZH, përshëndeti të gjithë të pranishmit! Tha, ne jemi në fillimet e procesit buxhetor, dhe siç e dini procesi buxhetor, fillon dikun në muajin maj dhe përfundon në muajin shtatorë të vitit fiskal, kur edhe bëhet aprovimi i buxhetit nga ana e kuvendit Komunal, me 30 prill qeveria e Kosovës ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve për periudhën

2020-2022, ndërsa me 17 maj ne kemi pranuar qarkoren e par buxhetore nga ministria e Financave dhe kufijtë fillestar buxhetor për Komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2020-2022, po sa e kemi pranuar Qarkoren Buxhetore ne kemi filluar me punimin e draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore të cilën e keni para vetes, dhe tani jemi në fazën e konsultimeve me publikun dhe deri në fund të muajit qershor në mbledhjen e ardhshme të kuvendit Komunal pritet aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2020-2022 e cila do të merr edhe imputet nga debatet publike, sa i përket procesit buxhetor puna nuk përfundon me aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, menjëherë fillon procesi i ri buxhetorë i cili zgjat gjate muajit korrik dhe gjate muajit gusht deri në muajin shtatorë ku bëhet aprovimi nga ana e kuvendit Komunal. Ndërsa sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2022 bazë për hartimin e kësaj kornize ka shërbyer korniza afatmesme e shpenzimeve të Qeveris së Kosovës dhe strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Klinës 2017-2021 , nga prioritetet kryesore të strategjisë të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik lokal të komunës se Klinës të cilat janë të përcaktuara në këtë dokument strategjik, kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik që nënkupton zhvillimin e ndërmarrsis, bujqësisë, turizmit, mandej zhvillimi i infrastrukturës që nënkupton rrugë, ujësjellës, kanalizime, dhe shërbime publike, mandej përmirësimi i cilësisë përmes investimeve në arsim , në shëndetësi. Sa i përket kornizës fiskale Komunale aktualisht financimi Komunal burimet e financimit përfshin tri burime kryesore e ato janë granatet qeveritare, që vijnë në formë të garantit të përgjithshëm, grantet për arsim, shëndetësi, mandej të hyrat vetanake të Komunës, qe nënkupton të hyrat tatimore dhe jo tatimore dhe grantet e donatorve të brendshëm dhe të jashtëm. Bazuar në qarkoren fillestare buxhetore numër një të ministrisë së financave dhe në parashikimet e parametrave makro ekonomik parashihet që për periudhën 2020-2022 sipas viteve të hyrat buxhetore komunale të jenë: për vitin 2020 në vlerë prej 11.054.140,00, për vitin 2021 në vlerë prej 11.413.433,00, dhe për vitin 2022 në vlerë prej 11.806.926,00 pra nëse e krahasojmë vitin 2019 me vitin 2020 buxheti do të jetë me i madh për 1 milion euro dhe për vitet vijuese do të jetë dikun 400 mijë për secilin vit. Në Kornizën Afatmesme të shpenzimeve janë përfshirë edhe projekte që planifikohen të realizohen në periudhën afatmesme 2020-2022 me financim nga ministria e linjës në vlerë totale 8.380.000 ndërsa sa i përket parashikimeve afatmesme të shpenzimeve komunale për përdhën 2020-2022 tek kategoria e pagave dhe mëditjeve kemi planifikuar një rritje dikun 500 mijë euro kjo për shkak aplikimit të ligjit për paga, dhe në vitet vijuese me një rritje dikun 2%, përkundër rritjes në kategorinë e pagave jemi përpjekur të ruhet struktura buxhetore e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike kjo që është edhe për vitin 2019, dhe për vitin 2020 pagat marrin pjesë në strukturën e përgjithshme të buxhetit një përqindje prej 59% mallrat dhe shërbimet rreth 10% komunalit me 1.63% dhe subvencionet me 1.81% ndërsa ato kapitale 28% kjo është një pasqyrë e shkurtër e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2020-2022, pra mund ta shikoni edhe draftin të cilin e keni para vetës, për vitin 2020 i bie dikun 61 projekte në vit po ashtu për vitin 2021 kemi planifikuar 61 projekte ndërsa për vitin 2022 dikun 40 projekte qe gjithsej i bie dikun 160 projekte kapitale, ne mirëpresim çdo vërejtje apo sugjerim nga ju deri në momentin e aprovimit nga kuvendi Komunal.

z.Fadil Gashi, kryesues, falënderoj drejtorin! Dhe hapi Debat për Kornizën Afatmesme Buxhetore, duke i përfshirë të gjitha këto të cilat i tha drejtori, ju tashmë e keni edhe materialin para vetës ku janë të përfshira të gjitha fushat dhe programet se ku është i orientuar buxheti sipas viteve të planifikuara, nëse ka dikush diçka urdhëroni?!

z.Mark Gjinaj, unë i pash disa projekte këtu në këtë draft por desha që të informohem me saktësisht a ka ndonjë projekt për fshatrat Videj, Paskalic dhe Jagod, dhe trotuari ku ceket Klinë-Videj a e përfshin edhe fshatin Paskalic sepse ne faktikisht jemi Videjë kaq pata faleminderit?

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, falënderoj Markun, tha, sa i përket atyre tri fshatrave Zajm, Videj, Jagod këtë vit do të filloj rruga e cila do ti përfshijë të gjitha ato fshatra duke përfshirë edhe Paskalicën, këtë vit do të ketë edhe kanalizim në Jagodë në vlerë të projektit prej 40 mijë euro, ndërsa për vitin e ardhshëm është planifikuar renovimi i rrugës nga sheshi Faruk Elezaj, QKMF-ja dhe deri në udhëkryqin tek fshati Jagodë e cili bashkon me rrugën Zajm Jagodë por gjithsesi vitin e ardhëm do të ketë pjesë të kanalizimeve që do ti përfshin fshatrat Paskalic dhe Videjë dhe Jagodë.

Florida Gashi OJQ “KOHA”, fillimisht ju falënderoj për këtë debat të cilin e keni organizuar, ju përgëzoj edhe për organizimin të cilin e keni organizuar neper fshatra duke pas parasysh që jo të gjithë qytetaret mund të vijnë kjo për shkak edhe të temperaturave të larta, gjithashtu me duhet të ju përgëzoj edhe për aspektin gjinorë, unë po e shoh se planifikimi është bërë edhe në baza të popullsisë, unë po shoh se në aspektin e investimeve ka shumë projekte që kanë të bëjnë me asfaltime dhe kanalizime, nuk po shoh ndonjë projekt që do ti ndihmonte grave vajzave dhe rinisë, unë po ndalem tek ndërtimi i stacionit të autobusëve, a është përcaktuar ndonjë lokacion për stacion? Po ashtu tek ndërtimi i sheshit ku janë paraparë 60 mijë euro nëse mundeni të na sqaroni pak këtë, si dhe tek ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në Klinë, sepse tashmë janë të emërtuara rrugët dhe të ishte me specifik në këtë rast se në cilën rrugë dhe cilën lagje do të ndërtohen?!

z.Fadil Gashi, kryesues, tha, faleminderit Florida, Kryetari i Komunës së bashku me drejtoret e drejtorive kanë planifikuar do të kenë takime edhe nëpër mjedise të caktuara, ne po mundohemi që të jemi sa më afër me qytetaret që të jenë edhe ata pjesë vendimmarrjes

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, falënderoj Florida Gashin, tha, sa i përket stacionit të autobusëve ne jemi përcaktuar të jetë tek Tregu i Gjerbert ku tashmë është parking, tashme kemi ndarë edhe një shumë për fillimin e ndërtimeve në vitin e ardhshëm, por nuk do të thotë se kjo është përfundimtare për arsye sepse do ti nënshtrohet edhe aprovimit në asamble, kuptohet edhe instancave tjera, ndërsa sa i përket trotuareve ne kemi kërkuar nga ministrit e linjës që te na mbështesin financiarisht për ndërtimin e rrugëve të cilat gjinden rreth qytetit, si rruga Klinë-Dresnik, Klinë-Dollc, Zajm-Deiqë, dhe ideja jonë është që të bashkohen trotuaret, pastaj kemi aplikuar që të mbështem financiarisht për projektin e trotuareve në rrugën e gjimnazit nga Komuna deri tek shkolla e mesme “Luigj Gurakuqi”, pastaj ka edhe tjera sepse kemi aplikuar në

shumë grante në të cilat mund të jemi përfitues, kështu që më mirë e kemi par të arsyeshme që ta lemë si fond trotualet në qytet sesa të përcaktohem dhe me pas të na shkojnë damë, por edhe kërkesat që do ti marrim nga qytetaret, edhe kërkesa për këto financime pra kjo ka qenë ideja se pse kemi shkuar në këtë formë për momentin. Ndërsa sa i përket sheshit, ju po e shihni se po vazhdojnë punimet, vitin e kaluar kemi paguar rreth 200 mijë euro, vitin 2018 nuk e kemi pasur linjë buxhetore dhe kjo ka qenë pengës e madhe për ne, kështu e që e kemi lan linjë buxhetore, po mendojmë mvarshisht nga suksesi i punimeve sepse edhe kompania ka ende punë shumë, ka edhe mangsi, është kompania që e mbikëqyr projektin nuk është më Komuna është një kompani private, këtu mendojmë që edhe sheshin “Muj Krasniqi” tek rrethi ta shndërrojmë si lloj amfiteatri ose skenë që në të ardhmen aktivitetet kulturore të zhvillohen në atë pjesë, për momentin e kemi lan në të dyja anët, që të mbështetet financiarisht. Projekti që është në vazhdimësi e sipër po shoqërohet me shumë probleme sepse tani këto ditë jemi duke lidhur gypat e ujit të pijes dhe po ka ndërprerje me furnizim të ujit në qytet, por po ka edhe disa defekte si rënie pllakave dhe gurëve dekorativ sepse nuk janë vendosur në mënyrën të duhur.

z.Fadil Gashi, kryesues, Faleminderit kryetar, theksoj se edhe për buxhetin gjinor mendoj se deri në draftin final do të ndahet buxhet ekskluzivisht gjinor, edhe vitin e kaluar ka pasur ndarje të buxhetit gjinorë por do të ketë prapë, urdhëroni drejtor.

z.Aziz Desku drejtor i FEZH, tha, ne e kemi Kornizen afatmesme buxhetore, ku projektet që realizohen në një lokalitete, qoftë në qytet apo në fshatra të komunës së Klinës si bazë për aspektin gjinorë na shërbejnë të dhënat statistikore mbi numrin e popullsisë d.m.th përbërja e popullsisë nga aspekti gjinorë që përfitojnë nga ai projekt, nëse realizohet një projekt në shkollë si bazë shërben numri i nxënësve meshkuj femra, kjo vlen edhe në shëndetësi, por ne ende nuk kemi ndonjë linjë të veçante, por gjatë përgatitjes së buxhetit një linjë buxhetore që do ti kushtohet ekskluzivisht aspektit gjinorë, respektivisht gjinisë femër, këtë qeshtje do ta marrim seriozisht gjatë procesit buxhetor, dhe ta marr vendin e merituar.

z.Qunë Selmanaj, Përhëndeti të gjithë, tha, jam banorë i banesave tek ish shtëpia e mallrave, banoj në katin e sipërm, kam një shqetësim sepse kemi mungesë të ujit, po ashtu kemi problem edhe me qatin sepse kur ka reshje atmosferike ka rrjedhje të ujit në banesa, a kish pas ndonjë mundësi që të shtohet si projekt edhe kjo kërkesë e jona?

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, faleminderit, sa i përket çështjes së ujit jam i informuar, kemi biseduar bashkë edhe me Hidro Drinin, por këto ditë mund të jetë edhe si pasojë e lidhjeve që po bëhen me galerinë e qytetit, ndërsa sa i përket rrjedhjeve të ujit të qetisë, kemi probleme të vazhdueshme edhe Komuna edhe shtëpia e kulturës, por edhe banesat kolektive pothuajse shumica e kanë këtë problem, ndoshta do të ishte mirë që ta debatojmë me drejtorin për buxhet që ta krijojmë një kod buxhetorë që do të na shërbente për renovimin e këtyre objekteve, për momentin nuk mundem që të jap një përgjigje të saktë se këto që janë të banuara me qytetarë a mund apo jo të hyjmë në bashkëfinancim, por do ta shikojmë mundësin sepse kam dy apo tri kërkesa të kësaj natyre.

z.Xhem Manaj, përshëndeti të gjithë të pranishmit! Për mua qeshtje e rëndësishme është ujësjellësi në fshatin Gllarevë, në vitin 2009 është ber shtrimja e gypave të ujit, por fatkeqësisht sot e asaj dite projekti nuk është funksional edhe pse ka qen një projekt 300 mijë euro, si e parashihni ju çështjen e këtij ujësjellësi?

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, faleminderit, po këtë vit është një projekt i planifikuar nga CDI ku ende nuk ka filluar, e ku janë se bashku Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës, ka rreth 800 mijë euro të planifikuara për investime në fshatrat lindor të Komunës se Klinës, por në buxhetin e vitit 2019 është paraparë gjetja e ujit për fshatrat Gllarev dhe Budisalc, në kohën kur ne po flasim kompania është në teren duke vepruar, tash është në fshatin Përqevë unë personalisht kam qen në teren për të parë punimet, ata janë duke i kryer disa matje gjeo-fizike, qëllimi i projektit këtë vit është gjetja e ujit, dhe vitin e ardhshëm parashihet ndonjë shpuarje tjetër me qëllim gjetjen dhe furnizimin me ujë, por projekti që parashihet nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Zvicerane, parashihet furnizimi me ujë nga burimi i Jerinës, por kemi probleme të caktuara për shkak të kualitetit të ujit dhe hezitimi i fillimit të projektit lidhet mu me këtë detaje, për atë ne po punojmë në planin tjetër e që do të kemi furnizim me ujë për të gjithë banoret e komunës se Klinës nga Drini përmes procesimit të ujit, përmes fabrikave të ujit siç është kjo aktuale por edhe me rritjen e kapaciteteve, rezultatet e projektit do të jen te gaqme dikun deri në datën 15 korrik dhe ne do të fillojmë menjëherë me hulumtim për mbështetjen financiare të këtyre projekteve.

z.Mustaf Beqiri, përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha, jam banor i Komunës se Klinës, banoj në rrugën Skender Regjepi, nuk kam ndonjë vërejtje sepse të gjitha rrugët brenda qytetit janë rregulluar për lakmi, por desha vetëm një sugjerim rrugën në të cilën unë banoj ka qenë rrugë një kahore dhe është ber dy kahore ne si qytetar të asnjë lagje po kemi probleme për kalimin e rrugës prandaj edhe po paraqet rrezik, nuk e di si e parashihni me tej.

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, faleminderit Mustaf, unë besoj që të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe se për momentin është pak vështir me ba riorganizimin të cilin e kanë pasur drejtimet e lëvizjes se veturave, por unë mendoj që do të gjejmë një zgjidhje kur të rregullohet rruga e transitit, kjo është përkohësisht, dhe ne mendojmë se pas një viti do të jetësohet edhe kërkesa e juaj se bashku me rrugën e transitit

z.Simon Simonaj, banor i Klinës në rrugën “Jusuf Gervalla”, kam një shqetësim në lidhje me ndriçimin e rrugës të cilin e ka dëmtuar kompania Mirusha, kam kërkuar që të merren masa dhe të rregullohet kjo qeshtje, kam edhe një kërkesë për asfaltimin e rrugës edhe pse jemi një laxhe e vjetër në Komunën e Klinës asnjë pushtet deri tash nuk ka investuar në atë laxhe a është e paraparë apo jo asfaltimi i rrugës në atë laxhe?

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, Faleminderit Simon, jam në ngjarje sa i përket ati dëmtimi të kabllit të ndriçimit unë personalisht kam qenë në vend të ngjarjes bëhet fjalë vetëm për ndreqim publik, kam biseduar edhe me drejtorin për shërbime publike do të marrim masa dhe do

ta sanojmë, ndërsa sa i përket asfaltimit të rrugës këtë vit janë të parapara të shtrohen të gjitha ato rrugë që gjinden në atë laxhe, projekti është në faza të tenderimit nëse nuk ka ankesa brenda muajit do të fillojnë edhe punimet.

z.Martin Rrustemi, përshëndeti të gjithë, tha se po e shoh se është bërë një punë e mirë gjatë përgatitjes së këtij drafti por po i shoh disa mangësi si p.sh. nuk është paraparë asgjë për shoqatën e peshkatarëve si dhe rrethojën(rezervatin) e shoqatën e gjuetisë, a keni paraparë diçka?

z.Aziz Desku drejtor i FEZH, ne kemi planifikuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore kemi planifikuar rritjen në kategorinë në subvencione nga 105 mijë në 200 mijë euro prandaj nga kategoria për subvencione financohen shumë kategori, pjesa më e madhe i kushtohet zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Klinës, mandej edhe rasteve shëndetësore, financimit të klubeve sportive, dhe në kuadër të kategorisë për subvencione do të ketë mundësi edhe të financimit të këtyre që përmende, por duhet ta keni parasysh që tash ndarja e subvencioneve bëhet përmes një rregulloreje të cilën e ka miratuar ministria e financave dhe bëhet përmes shpalljes publike dhe përmes aplikimit të shoqatave për thithjen e fondeve nga kategoria e subvencioneve.

z.Marian Berisha, përshëndeti të gjithë! Jam banor nga Klina banoj në laxhën mbi hekurudhë, e di që keni bërë një punë të mrekullueshme, por duhet menduar një zgjidhje për ujërat dhe rrëzën e cila vije nga ana e nëntë kur ka reshje pastaj bllokohen vendet ku kalojnë këto ujëra, mendoj se qytetit duhet ti japim prioritet pak më shumë.

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, faleminderit Marjan, por edhe ajo pjesë njëjtë si pjesa tjetër e rrugës "Jusuf Gervalla" të cilën edhe e cekem më heret, edhe ajo është në fazë të tenderimit dhe shumë shpejt edhe do të fillojmë me punimet, do të kryhet edhe kanalizimi sepse është edhe i paraparë, kohet e fundit po kemi edhe problem nga dukurit e natyrës siç janë shirat e rrëmbyeshëm është problem ti bëhet zgjidhje për një kohë të shkurt brenda vitit, ato do të duhet të parashikoheshin mirë me parametra vlerësues, por rregullimi i rrugëve do ta minimizoj atë problem.

z.Faton Berisha, fillimisht ju përshëndes, unë shikova draftin dhe pash që në lokalitetin ku unë jetoj në fshatin Qeskovë nuk pash ndonjë planifikim për ndonjë investim, ju jeni të zgjedhur që ti orjentoni politikat zhvillimore që do ti zgjidhnin problemet tona, po shikoj shumë projekte të cilat janë të degjeneralizime dhe nuk po janë të qarta, p.sh. mirëmbajtja dhe zgjerimi i parqeve 10 mijë euro se di se për cilat parqe bëhet fjalë, po ashtu po shikoj shumë projekte për ndërtim të kanalizimit, por vetëm dy projekte i pash për ndërtim të impiantit për pastrim të ujerave të zeza, po ashtu pash vetëm dy projekte për ndërtim të impianteve të cilat janë për t'ju propozuar ministrive përkatëse, pash disa planifikime për gjelbërim por nuk ceket se në cilin vend do të zbatohet ky projekt, unë mirëpres këtë sepse kjo është me rëndësi të veçantë për të ardhmen.

z.Fadil Gashi, kryesues, tha, unë kam një lutje për të gjithë, ta dallojmë kjo është kornizë afatmesme buxhetore për tri vitet e ardhshme, ky është vetëm hapi i par, pastaj vazhdojmë me plotësime, por ideja është të investojmë në ato fusha, edhe në impiante të pastrimit edhe në

ruajtje të ambientit, por kur të miratohet buxheti do ti shihni me te detajizumë ne shtator kur edhe miratohet buxheti, nuk ka mjedis qe nuk do preket nga investimet.

z.Shaqir Elezaj, përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha, e shikova me kujdes këtë draft dhe pash se është gjithëpërfshirës dhe se përfshin çdo lokalitet, mirëpo unë kam tri kërkesa: një ka te bej me ujë te pijes është i informuar edhe kryetari se në fshatin Gjurgjevik i vogël ka mungesë te ujit të pijes, shqetësim tjetër është mungesa e wc-ve publike, dhe kërkesa e tret ka te bej me qentë endacak a keni menduar për ndonjë zgjidhje?

z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, faleminderit, sa i përket ujit e thash edhe me herët projekti i cili ka filluar nga qeveria Zvicerane parasheh qe te behët një zgjidhje edhe për Gjurgjevikun e vogël sepse për momentin furnizimi me ujë behët nga Jashanica e epërme dhe kuptohet kapacitetet e bazeneve, te rezervarëve janë të vegjël kështu që është paraparë një zgjidhje tjetër, ende nuk ka filluar projekti ne po presim dita e ditës sepse ata po kërkojnë nga ne sasinë e ujit dhe ne me fjalë nuk mund ti garantojmë duhet me vepra dhe me vepra është studimi qe po e bëjmë dhe kuptohet qe momentin qe ne do të fillojmë projektin ata do të fillojnë realizimin e projektit. Ndërsa sa i përket qenve endacak, ju shumica e dini se është një Project i nivelit qendrorë për ter Kosovën që e implementon agjencia e veterinars, ideja qe ta kenë ata në kompetencë këtë Project ka qen sepse komunat kur kanë ber projekte te veçanta, ka qen një dukuri të cilën ata e kanë identifikuar se operatorët p.sh kanë marr qen nga Komuna Klinës dhe u kanë dërguar në Istog, njëfarë forme kanë ber keqpërdorime, mirëpo edhe ky Project që po implementohet nga kjo agjenci po shoqërohet me shumë mangësi, pra Komuna nuk ka kompetenca, e di që është shqetësim për qytetar, do ta shikojmë në shtator kur edhe behet aprovimi i buxhetit për vitin 2020 te jetë ndonjë Project shitesë. Ndërsa sa i përket wc-ve publike, po presim që të përfundoj sheshi dhe kemi një ofertë, do të na sjellin një stacion ku qytetarët kanë mundësi të presin autobusin pra njëkohësisht ato kanë edhe wc-en, ne do ta shikojmë se si po funksionon ajo dhe me pas ta furnizojmë edhe më disa në vende të tjera.

z.Edmond Racaj, pyetja ime ka të bej me drejtorin për buxhet dhe financa, këtu tek drafti fig.1 buxheti total i Komunës në vite shihet një rritje në vitin 2020 behet fjalë për një rritje 1 milion euro që realisht nuk janë shumë një milion euro, por në një rritje është e madhe kjo i bie dikun 10% të shumës totale te buxhetit për vitin 2019, menjëherë mbrapa në figurën dy shihet një ulje tek te hyrat vetanake dikun 6000 euro me intersoj se si është paraparë gjenerimi i një rritjeje kaq të madhe kur dihet se në vitin 2020/2021 keni paraparë rritje vetëm 400 mijë euro, ndërsa pika tjetër ka bëj me ndërmarrjet e vogla dhe te mesme, po e shoh një fond se janë ndarë 29 mijë euro për vitin 2020 për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, unë nuk e di se sa është sakt numri i ndërmarrjeve te vogla dhe te mesme por po e marrim se është 29 ndërmarrje dhe kjo I bie se do ti marrin vetëm nga 1000 euro që është një ndihmë jashtëzakonisht e vogël, unë kisha pas dëshirë qe të rritet kjo shumë, por edhe nëse nuk ka mundësi të rritet kjo shumë te paktën te caktohet se për cilat ndërmarrje te vogla dhe te mesme po behët fjale te paktën te jetë një strategji tek paparsit konkurruese, e pash edhe një table se si jeni munduar qe ta matni arritjen e këtyre objektivave që është shumë në rregull, por besoj që është shumë e vështirë e matshme duke i ditur

trendët e lëvizjeve të ndërmarrjeve të medhaja se jetëgjatësia e bizneseve të ne Kosovë është shumë e vogël dy vjet ose tri vjet është mesatarja, nuk po flas për korporata por po flas për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, po e zam sot është themeluar dhe pas një viti mund të mos jetë në ekzistencë ajo ndërmarrje më, si do ta matni?

z.Aziz Desku drejtor i FEZH, tha, tek tabelari pra financimi Komunal 2019-2022 sipas burimeve të financimit, këto janë prej parametrave ekonomik që janë dhen me qarkoren buxhetore nga ministria e financave dhe këta janë në fakt kufijtë fillestar d.m.th kur të lëshohet qarkorja e dytë buxhetore do të ketë mundësi që të ketë ndonjë ndryshim për rritje apo zvogëlim, ndërsa sa i përket të hyrave vetanake, të hyra vetanake kanë pasur rritje mirëpo është ber një ndryshim me ligjin e financave lokale, ku tani me planifikimin e ri gjobat që vijnë si të hyra nga trafiku dhe nga gjykata nuk do të planifikohen më nga Komuna, ato do të jen të hyra të Komunës për shfrytëzim por komuna nuk i planifikon sepse ato i mbledh një institucion tjetër pra ministria e brendshme, pra po ti shtojmë edhe këto të hyra e vërejmë se ka rritje të hyrave, sa i përket fondit për ndërmarrjet prodhuese ne konsiderojmë se shuma e planifikuar me të vërtet është e vogël dhe në përgjithësi Komunat në këtë fazë nuk kanë ende mundësi që të bëjnë shumë me shumë në këtë drejtim, por ne jemi përpjekur edhe gjatë këtij viti por edhe gjatë vitit të kaluar se sa here që ka pasur grante nga ministrit e caktuara ne jemi munduar ti njoftojmë bizneset Klinase, në mënyrë që të aplikojnë dhe të përfitojnë nga ato grante, por kjo shumë e cila është planifikuar për vitin 2020 me shumë ka të bëjë me një përkrahje që do të mund të përfitonin bizneset e reja, për arsye se për bizneset prodhuese një shumë e tillë është simbolike dhe nuk garanton që mund ta zhvillojë një biznes, këto kriteret për matje të performancës janë disa të dhëna statistikore mbi bazën e një analize ekonomike por që vërtet janë vështirë të matshme dhe të saktësuara që a do të mbërrihen ato duke pasur parasysh edhe atë që ti përmende me herët, një numër i bizneseve ka jetëgjatësinë e vogël, ky trend pra është botëror jo vetëm në Kosovë.

z.Fabjan Palucaj, përshëndetje për të gjithë! Unë jam Fabian Palucaj nga Klina, kam një shqetësim në zonën tek fushat e Dresnikut, aty po behën ndërtime pa leje duke i zen edhe kanalet e ujitjes të cilat kanë shërbyer për ujitje të tokave në atë pjesë pra ato kanale i kanë shndërruar në rrugë, pra po behën ndërtime pa kurrfarë leje dhe kurrfarë kriteri kjo për mua është shqetësuese, si do të veprohet me tutje për atë zonë, a do të urbanizohet ajo pjesë apo do të ndalen ndërtimet?


z.Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, Faleminderit, pjesa e Dresnikut është shqetësim edhe i yni mirëpo të gjitha ato ndërtime janë ndërtime pa leje, dhe në kuadër të projektit hartat zonale të Komunës së Klinës ne kemi kërkuar nga kompania e cila është implementuese që ta bëjë një incizim me dron të situatës ekzistuese, dhe mbi bazën e këtij incizimi kemi ber një lloj interkulimi të mundshëm që ta ruajmë ndonjë pjesë të Tokës bujqësore, kohë me par ju e dini se si janë ndërtuar ato shtëpi, por neve na duhet që të marrim masa me tutje dhe ta ndalojmë ndërtimin pa leje, por është edhe ligji për legalizim, mirëpo në kuadër të hartës zonale ne kemi bër një propozim që do të jetë propozim edhe për organin vendimmarrës asamblenë Komunale dhe për organin i cili e vlerëson ligjshmërinë e vendimit pra ministria e linjës, ne se shpejti do të

dalim me harta zonale dhe nga ai moment që harta zonale do të aprovohet, harta zonale do të jetë obligim i qeverisjes dhe nuk do të lejohet më ndërtim pa leje.

z.Fadil Gashi, kryesues, Nëse ka dikush diçka urdhëroni, nëse jo unë me kaq po e mbylli këtë mbledhje ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe kontributin e dhenë.

Mbledhja e debatit me publikun përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi,
Ahmet Berisha



Kryesuesi,
Fadil Gashi

